



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr.154, dt. 12.05.2017

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren e miratuar me vendim KKR nr. 75, date 03.04.2015 “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 12.05.2017 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për ark. Daniel Pirushi,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, me nënkategoritë AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 dhe kategorinë AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me nënkategoritë AZ/1, AZ/2, AZ/3, AZ/4 sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të ark. Daniel Pirushi,
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e ark. Daniel Pirushi, me licensë restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë AP. “Projektim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”, me nënkategoritë AP/1, AP/2, AP/3, AP/4 dhe kategorinë AZ. “Zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me nënkategoritë AZ/1, AZ/2, AZ/3, AZ/4.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI